



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Nr. Prot. 1484 Dt. 06.08.2021

Në bazë të vendimit të Senatit të datës 30.06.2021, sipas propozimit të njësive akademike, dhe pas miratimit nga MASHTI, si dhe bazuar në Ligjin për provimin e maturës shtetërore dhe vendimin e MASHTI Nr. 2/3034 dt. 08.07.2016, Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë – UIBM, shpallë

KONKURS

për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore – bachelor në vitin akademik 2021/2022

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë, në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik **2021/2022**, do të regjistrojë **955** studentë të rregullt.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHTI, UIBM do të regjistrojë deri në 12%, përkatësisht deri **113** studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
3. Në UIBM, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT, mund të pranohen edhe kandidatët nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvegja, Maqedonia dhe Shqipëria. Numri i studentëve të rregullt që do të pranohen nga këto vende do të jetë 1% e numrit të përcaktuar si në paragrafin 1 të pikës I, përkatësisht deri **11** studentë. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërshënuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'iu nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova.
4. Përfundimisht kushteve të veçanta të përcaktuara për kandidatët si në pikën 2 dhe 3, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.
5. **Mbi bazë të konsideratave humane, UIBM rezervon të drejtën e pranimin të kandidatëve me nevoja të veçanta të cilët statusin e tyre duhet ta dëshmojnë me certifikata përkatëse, të lëshuara nga institucionet gjegjëse.**
6. Universiteti nuk do të ju mundësojë lehtësira për pranim nëse njeri prej kandidatëve binjak nuk pranohet në programin e njëjtë apo të ndryshëm me binjakun tjetër.
7. Të drejtë pranimi në UIBM kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët shkollimin e mesëm e kanë përfunduar në njërin prej shkollave publike apo shkollave private të licencuara në Republikën e Kosovës dhe që e kanë diplomën për shkollimin e kryer
8. Në UIBM mund të pranohen edhe studentët nga shtetet e tjera, në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.
9. Kandidatë jo-kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe që nuk kanë nënshtetësi Kosovare.

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1



UNIVERSITETI - UNIVERSITY "ISA BOLETINI" MITROVICË

10. Dëshmia për njohjen dhe për barasvlerën e diplomës merret në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), ndërsa barasvlera e notave do të bëhet nga Zyra për sigurimin e cilësisë e UIBM.
11. UIBM do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak ose/dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram.
12. Njësitë akademike përkatëse të UIBM, me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
13. Deklarimi i rrejtshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale: *"çdo kandidatë që mbi bazën e deklaramit të rrejtshëm, apo dokumentacionit të falsifikuar ka arritur të pranohet në mënyrë të padrejtë në UIBM, do të përjashtohet në mënyrë automatike nga UIBM, në momentin e vërtetimit të një fakti të tillë"*.
14. **Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të UIBM nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UIBM pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.**
15. **Kandidatët për pranim si student të UIBM-it në vitin akademik 2021/22 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet apo program.**

II. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës më së largu dy (2) ditë pune pas publikimit të rezultateve. Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga fakulteti përkatës, vendimi përfundimtar rreth ankesës merret brenda tri (3) ditëve të punës nga shpallja e rezultateve preliminare.

III. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet e poshtëshënuar:

Fakulteti i Gjeoshkencave, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, do të bëhet sipas kritereve në vijim:

a. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

1. Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
2. Suksesi në provimin pranues deri në 70 pikë.

b. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

1. Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
2. Suksesi në maturë deri në 30 pikë;
3. Suksesi në provimin e maturës nga lëndët me përparësi për regjistrim në Fakultet deri në 40 pikë.

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Lëndët me përparësi për regjistrim në Fakultet janë të shënuara në pjesën e konkursit ku bëhet fjalë për secilin prej këtyre fakulteteve.

2. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet e poshtëshënuara:

Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Edukimit do të bëhet sipas kritereve si në vijim:

a. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

1. Sukses në shkollën e mesme deri në 30 pikë; dhe
2. Sukses në provim pranues deri në 70 pikë.

b. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

1. Sukses në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
2. Sukses në maturë deri në 30 pikë; dhe
3. Sukses në provimin pranues deri në 40 pikë.

3. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
4. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
5. Përgjithësisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 3 dhe 4 të pikës III, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kritereve të përcaktuara si në paragrafin 2 dhe 3 të pikës I, të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm ata që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
6. Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues më së shumti në tri lëndë mësimore, të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
7. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve është i barabartë, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të përgjithshëm nga shkolla e mesme. Nëse edhe pas kësaj do të kemi të njëjtin rezultat, merret sukses nga lëndët e ngushta profesionale. Nëse rezultatet e numrit të barabartë të pikëve përsëritet, atëherë përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore. Në rastin e fakulteteve në të cilat organizohet provimi pranues përparësia e studentëve fillon nga numri i pikëve të fituara në provimin pranues, pastaj sukses nga shkolla e mesme dhe në fund përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore. Nëse edhe pas këtij kriteri numri i pikëve mbetet i barabartë atëherë zgjedhjen e kandidatëve do të bëjë komisioni përkatës i fakultetit.
8. Fakultetet janë të obliguara që tërë listën e kandidatëve, të cilët kanë konkurruar, t’ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e Universitetit.
9. Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

IV. AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. Aplikimi në platformën online <https://www.umib.net/> në linkun APLIKO, hapet prej datës **06.08.2021 deri më datë 24.08.2021 në ora 16.00**.
2. Aplikimi online do të funksionalizohet prej ditës së parë të konkursit, përkatësisht prej datës **06.08.2021, nga ora 10**.
3. Dorëzimi i dokumentacionit fizik, vetëm për kandidatët të cilët kanë aplikuar online, do të bëhet prej datës **25.08.2021** deri më datë **28.08.2021**. Gjatë kësaj periudhe gjithashtu do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personeli i administratës së fakultetit përkatës.
4. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve dhe të njëjtat t'i noterizojnë (vula noterit duhet të jetë origjinale), sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo ç' regjistrim nga fakulteti.
5. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim online dhe fizik është si në vijim:**
 - a) *Ekstrakti i lindjes (original), jo më i vjetër se 6 muaj;*
 - b) *Kopja e letërnjoftimit;*
 - c) *Dëftesa e të gjitha klasave të shkollës së mesme (original, të noterizuara ose duplikat)*
 - d) *Diploma e kryerjes së shkollës së mesme (original, të noterizuar ose duplikat;*
 - e) *Dëftesa e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (original, të noterizuar ose duplikat)*
 - f) **Vërtetimi mbi pikët e fituara në provimin e maturës për lëndët mësimore (vetëm kandidatët për fakultetet: Fakulteti i Gjeoshkencave, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike);**
 - g) **Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: Vegza (linku) për konkurrim online përmes internetit është: <https://www.umib.net/> në linkun APLIKO;**
 - h) *Pagesën prej 2.5 Euro. Forma e pagesës shkarkohet dhe shtypet nga ueb-faqja e Universitetit të Mitrovicës, ndërsa pagesa bëhet në bankat afariste ose në filialet e Postës;*
 - i) *Dëshmia mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit-Lista e institucioneve parauniversitare të licencuara në vend, sigurohet në MASHTI nga Administrata Qendrore e UIBM (nëse kandidatët nuk mund ta sigurojnë këtë dëshmi gjatë periudhës së aplikimit online, atëherë dëshmia mund të dorëzohet me rastin e aplikimit fizik).*
6. **Me rastin e aplikimit në datat e caktuara si në pikën 3 të kapitullit IV, të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e kërkuara si në pikën 5 të këtij kapitulli, t'i dorëzojnë në sportelet e fakulteteve në dosje (fashikull) të bardhë, e cila duhet të jetë unike për të gjithë kandidatët.**
7. **Të gjithë kandidatët janë të obliguar që të respektojnë rekomandimin e IKSHP për ruajtjen e distancës prej 1,5-2 metra dhe të përdorin maskën mbrojtëse.**
8. Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse, si dhe në ueb-faqet e këtyre fakulteteve.
9. Datat e mbajtjes së provimeve pranuese në fakultetet e ndryshme janë të shpallura në vijim:



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Provimet pranuese do të mbahen sipas këtij orari:

Më 31.08.2021, në orën 9:00 Fakulteti i Edukimit.

Më 31.08.2021, në orën 12:00, në këto fakultete: Fakulteti i Gjeoshkencave; Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike. (vetëm kandidatët me sistem të vjetër që nuk kanë provim të maturës).

Me 31.08.2021 në ora 13 Fakulteti Ekonomik.

Më 31.08.2021 në orën 15:00 Fakulteti Juridik.

10. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet të jenë të pajisur me maskë mbrojtëse (Vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës) dhe të kenë me vete letërnjoftimin ose pasaportën. Kandidatët nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues pa dokument identifikimi. Kandidatët të cilët nuk paraqiten në kohën e caktuar për mbajtjen e provimit pranues, sipas orarit të shpallur, nuk do të lejohen të marrin pjesë në provim. **Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!**
11. **Shpallja e rezultateve preliminare të provimit pranues do të bëhet, më së voni, deri më 02.09.2021 në fakultetet përkatëse si dhe në ueb-faqen e Universitetit.**
12. **Shpallja e rezultateve përfundimtare pas shqyrtimit të ankesave përkatësisht me datë 07.09.2021.**
13. **Në programet e studimit ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, do të shpallet konkursi plotësues.**
14. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose ta vizitojnë faqen e internetit: **www.umib.net**
15. **Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet prej 08.09.2021 deri më 14.09.2021, prej orës 9:00 – 15:00 (vetëm në ditët e punës).**
16. **Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, prandaj luten që t'i përmbahen afatit të lartshënuar.**
17. **Në qoftë se kandidati i pranuar, në afatin e caktuar nuk përfillë të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit.**
18. Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
 1. Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit.
 2. Studentët shtetas të Republikës së Kosovës që fillojnë studimet në Universitetin “Isa Boletini”, vitin e parë të studimeve e kanë falas.
 3. Pagesa për një semestër për studentë që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, do të jetë në lartësi prej **25 €** për studime të rregullta.
19. Pagesa për semestër bëhet në njëri prej bankave afariste ose në filialet e Postës me fletëparaqitje për pagesë, e cila shkarkohet dhe shtypet nga Ueb faqja e Universitetit “Isa Boletini”.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Numri i studentëve për regjistrim sipas fakulteteve dhe programeve të studimit

Fakulteti- Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, Maqedonia dhe Shqipëria	Gjithsej
Fakulteti i Gjeoshkencave	90	12	3	105
Gjeologji	52	7	1	60
Xehetari	21	3	1	25
Materiale dhe Metalurgji	17	2	1	20

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës, suksesi i të cilave do të merret parasysh për pranim, janë: Matematika, Fizika dhe Kimia.

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa provim të maturës, provimi pranues do të mbahet nga lënda: Matematikë.

Fakulteti- Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, Maqedonia dhe Shqipëria	Gjithsej
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	174	24	2	200
Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore	87	12	1	100
Teknologji: Specializimi Inxhinieri Kimike Specializimi: Inxhinieri mjedisore	87	12	1	100

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës, suksesi i të cilave do të merret parasysh për pranim, janë:

Programi Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore: Matematika, Biologjia dhe Kimia.

Programi Teknologji: Me specializime: Inxhinieri kimike; Inxhinieri e mjedisit: Matematika, Fizika dhe Kimia.

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa provim të maturës, provimi pranues do të mbahet nga lëndët:

Programi Inxhinieri edhe Teknologji Ushqimore: Biologjia dhe Matematika.

Programi Teknologji: Me specializime: Inxhinieri kimike; Inxhinieri e mjedisit: Matematika.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Fakulteti- Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, Maqedonia dhe Shqipëria	Gjithsej
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	367	50	3	420
Makineri Prodhuese	87	12	1	100
Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri	140	19	1	160
Inxhinieri Ekonomike	140	19	1	160

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës, suksezi i të cilave do të merret parasysh për pranim, janë: Matematika, Fizika dhe Informatika.

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa provim të maturës, provimi pranues do të mbahet nga lënda:

Fakulteti- Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, Maqedonia dhe Shqipëria	Gjithsej
Fakulteti Juridik	70	9	1	80
Juridik				

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Fillet e së drejtës, E drejta kushtetuese dhe Gjuhë shqipe.

Fakulteti- Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, Maqedonia dhe Shqipëria	Gjithsej
Fakulteti Ekonomik	87	12	1	100
Biznes dhe menaxhment specializimi – Banka Financa dhe kontabilitet	87	12	1	100

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi dhe Matematikë.

Fakulteti- Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, Maqedonia dhe Shqipëria	Gjithsej
Fakulteti i Edukimit	43	6	1	50
Arsimi Fillor	43	6	1	50

Provimi pranues do të mbahet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Letërsi shqipe dhe Matematikë.

